



## Udhëzimi 12

Shtator 2016

### Prokurimi publik

# Mjetet juridike

#### PËRMBAJTJA

- [Ku për të mësojmë në lidhje me mjetet juridike të disponueshme](#)
- [Qëllimi i Direktivave të mjeteve juridike](#)
- [Kush ka të drejtë të kërkojë mjete juridike?](#)
- [Cilat organe shqyrtojnë ankesat dhe rastet ligjore në lidhje me prokurimin?](#)
- [Cilat lloje të mjeteve juridike janë të disponueshme?](#)
- [Çfarë është "periudha e ankesave"?](#)
- [Pavlefshmëria e kontratave të lidhura](#)
- [Parimet e përgjithshme që duhet të respektohen nga organet shqyrtuese dhe autoritetet kontraktore në lidhje me mjetet juridike](#)
- [Informacion i mëtejshëm](#)

Autorizuar për botim nga Karen Hill, Drejtuese e Programit të SIGMA-s.

Mjetet juridike janë veprime juridike që u mundësojnë operatorëve ekonomikë që të kërkojnë zbatimin e rregullave të prokurimit publik dhe të të drejtave të tyre në bazë të këtyre rregullave në rastet kur autoritetet kontraktore, me qëllim ose pa qëllim, nuk vepron në përputhje me kuadrin ligjor për prokurimin publik.

## Ku të mësojmë në lidhje me mjetet juridike të disponueshme

**Direktivat e mjeteve juridike dhe e drejta vendore:** Mjetet juridike mbulohen nga kuadri ligjor i BE-së dhe nga të drejta vendore në zbatim të kësaj kornize. Kuadri ligjor i BE-së për mjetet juridike gjendet në Direktivën 89/665/KEE<sup>1</sup>, që lidhet me procedurat e dhënies së kontratave nga sektori publik, dhe në Direktivën 92/13/KEE<sup>2</sup>, që lidhet me procedurat e dhënies së kontratave nga ndërmarrjet e shërbimeve. Të dyja këto direktiva janë ndryshuar ndjeshëm nga Direktiva 2007/66/KE<sup>3</sup>. Në këtë analizë, këto tri direktiva janë referuar kolektivisht si "Direktivat e mjeteve juridike".

Direktiva e Koncesioneve 2014/23/BE ka prezantuar ndryshime të mëtejshme, që do të thotë se kontratat e koncesionit që i nënshtrohen Direktivës së koncesioneve janë gjithashtu edhe subjekt i Direktivave të mjeteve juridike.

Rregulla të caktuara procedurale janë përcaktuar në vetë Direktivat e mjeteve ligjore, por shumica e detajeve dhe e rregullave të veçanta procedurale zbatohen në të drejtën kombëtare.

## Qëllimi i Direktivave të mjeteve juridike

Qëllimi i Direktivave të mjeteve juridike është që të garantohet se parregullsitë që ndodhin në procedurat e dhënies së kontratës kundërshtohen dhe korrigjohen sa më shpejt që ato të ndodhin. Direktivat e mjeteve juridike duhet të rrisin ligjshmërinë dhe transparencën e procedurave të dhënies së kontratës, të ndërtojnë besimin mes bizneseve, dhe të lehtësojnë hapjen e tregjeve të kontratës publike vendore ndaj konkurrencës së huaj.

Është e rëndësishme që operatorët ekonomikë të kenë mekanizma në dispozicion që do t'u mundësojnë atyre që të zbatojnë rregullat e prokurimit. Këto mekanizma i inkurajojnë ata që të monitorojnë procedurat e dhënies së kontratave dhe të kërkojnë që rregullat e prokurimit të ndiqen në mënyrë që shanset e tyre për të fituar një kontratë nuk zvogëlohen në mënyrë të paligjshme. Kështu që këto mekanizma rrisin ligjshmërinë e procedurave dhe inkurajojnë konkurrencën.

Nisur nga qëllimi i Direktivave të mjeteve juridike del se të gjitha procedurat kombëtare të mjeteve juridike duhet të jenë:

- Të qarta dhe të drejtpërdrejta, d.m.th., të kuptueshme dhe të lehta për t'u përdorur nga operatorët ekonomik;
- Të disponueshme për të gjithë operatorët ekonomik që dëshirojnë të marrin pjesë në një procedurë të veçantë për dhënien e kontratës pa diskriminim, në mënyrë të veçantë për shkak të kombësisë;

<sup>1</sup> Direktiva 89/665/KEE mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të shqyrtimit për shpalljen fituese të kontratave të furnizimit publik dhe të kontratave të punëve publike, 21 dhjetor 1989, e ndryshuar.

<sup>2</sup> Direktiva 92/13/KEE mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e rregullave të Komunitetit për procedurat e prokurimit të subjekteve që veprojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe telekomunikacionit, 25 shkurt 1992.

<sup>3</sup> Direktiva 2007/66/KE që ndryshon Direktivën e Këshillit 89/665/KEE dhe 92/13/KEE në lidhje me përmirësimin e efektivitetit të procedurave të shqyrtimit që kanë të bëjnë me shpalljen fituese të kontratave publike, 11 dhjetor 2007.

- Efektive për parandalimin apo korrigjimin e rasteve të paligjshmërisë nga ana e operatorëve ekonomikë dhe/ose autoriteteve kontraktore.

### Kush ka të drejtë të kërkojë mjete juridike?

Direktivat e mjeteve juridike grasatojnë që mjetet të jenë në dispozicion të çdo operatori ekonomik që ka, ose ka pasur, interes në marrjen e një kontrate të veçantë dhe të rreziqeve, ose ka rrezikuar, duke u dëmtuar nga një pretendim për shkeljen e rregullave në fuqi të prokurimit.

Kjo dispozitë do të thotë se të gjithë operatorët ekonomik që kanë shprehur interes për të marrë pjesë në një procedurë të dhënies së kontratës - ose mund ta kenë bërë këtë gjë nëse kontrata ka qenë shpallur - kanë të drejtë të përfitojnë nga mjetet juridike në dispozicion.

Në përgjithësi, ligjet vendore për statusin dhe përfaqësimin në procedurat ligjore janë të zbatueshme në masën që ata nuk ndërhyjnë në kërkesat e Direktivave të mjeteve juridike.

### Cilat organe shqyrtojnë ankesat dhe rastet ligjore në lidhje me prokurimin?

**Ankesat para autoritetit kontraktor apo një autoriteti mbikëqyrës të autoritetit kontraktor:** Për të inkurajuar zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, pa ngritur padi ligjore, e drejta vendore mund të kërkojë ose të lejojë që operatori ekonomik në fjalë, para ndërmarrjes së një veprimi juridik pranë organit kompetent shqyrtues, të kërkojnë së pari shqyrtimin duke paraqitur një "kërkesë për shqyrtim" (d.m.th., një ankesë) pranë autoritetit kontraktor ndaj një shkelje të dyshuar në një procedurë të dhënies së kontratës. Ankesat nuk janë ndërmarrje veprimesh ligjore si të tilla, pasi ato paraqiten për t'u rishikuar nga organet para procedurave të tjera ligjore. Në varësi të fakteve dhe rrethanave specifike, ankesat mund të çojnë në zbatimin e ligjit dhe në zgjidhjen e shpejtë dhe të hershme të mosmarrëveshjeve.

**Tribunalet ose gjykatat:** rastet e prokurimit paraqiten para një organi shqyrtues, i cili mund të jetë ose një tribunal i specializuar për prokurimin ose një gjykatë të rregullt. Shtetet Anëtare janë të lira të zgjedhin në mes të dy organeve të shqyrtimit.

Për informacion të mëtejshëm shih Udhëzimin nr. 25 të SIGMA-s për Prokurimin publik, *Krijimi i organeve të shqyrtimit të prokurimit*.

### Cilat lloje të mjeteve juridike janë të disponueshme?

Dispozitat e detajuara në lidhje me llojet e mjeteve juridike të disponueshme në përgjithësi janë subjekt i së drejtës vendore. Direktivat kërkojnë që Shtetet Anëtare të garantojnë që të jenë në dispozicion tre lloje të mjeteve juridike: masat e përkohshme, masat pezulluese, dhe dëmet.

- **Masat e përkohshme:** masat e përkohshme janë masat e ndërmjetme që merren në lidhje me njoftimin e kontratës dhe çdo vendim kontraktor, duke përfshirë vendimin për dhënien e kontratës. Qëllimi i masave të përkohshme është parandalimi i krijimit të situatave të pandryshueshme dhe shmangja e vazhdimit të procedurës për dhënie të kontratës pa një operator ekonomik që në rrethana të tjera do të kishte qenë në gjendje të merrte pjesë dhe ndoshta t'i jepej kontrata. Këto synime mund të arrihen vetëm nëse sistemi ligjor vendor ofron një mundësi efektive, të thjeshtë dhe të shpejtë për marrjen e masave të përkohshme dhe në qoftë se organi kompetent i shqyrtimit nuk është i gatshëm për të dhënë ndihmë të përkohshme, si çështje parimore.
- Mund të vendosen masat e përkohshme në vijim:
  - Pezullimi i zbatimit të çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktor;
  - Pezullimi i të gjithë procedurës së dhënies së kontratës;

- Korrigjimi i përkohshëm i shkeljes (kjo masë e përkohshme varet nga e drejta vendore dhe është mjaft e pazakontë).
- **Masat pezulluese:** kërkesa për mjetet juridike të pezullimit anulon ose e bën të pavlefshëm një vendim kontraktor të marrë në mënyrë të paligjshme ose korrigjon një situatë të paligjshme. Qëllimi i të masave pezulluese është që të korrigjojnë parregullsitë e provuara. Ky qëllim arrihet vetëm nëse sistemi ligjor vendas siguron një mundësi efektive të anulimit të një specifikimi ose vendimi kontraktor të paligjshëm dhe në qoftë se organi kompetent i shqyrtimit shqyrtton arsyetimin e vendimeve kontraktore.
- Mund të vendosen masat e mëposhtme korrigjuese:
  - Heqja e specifikimeve diskriminuese teknike, ekonomike apo financiare në njoftimin e kontratës, dokumentet e tenderit ose nga çdo dokument tjetër në lidhje me procedurën e dhënies së kontratës;
  - Anulimi i një vendimi të paligjshëm kontraktor;
  - Korrigjimi pozitiv i çdo dokumenti apo vendimi kontraktor të paligjshëm, për shembull, një urdhër i autoritetit kontraktor për të ndryshuar ose fshirë një klauzolë të paligjshme në dokumentet e tenderit apo për të rikthyer një operator ekonomik që ishte përjashtuar në mënyrë të paligjshme.

Kur kanë filluar procedurat ligjore që kërkojnë masa të përkohshme ose masa pezulluese, a mundet autoriteti kontraktor të shkojë përpara dhe të japë kontratën? Direktivat e mjeteve juridike sigurojnë se kur kërkesa për masë të përkohshme ose kërkesa për masë pezulluese për vendimin e dhënies së kontratës zbatohet me anë të procedurave ligjore, atëherë autoriteti kontraktor nuk mund të lidhë kontratën derisa organi shqyrtues të ketë marrë një vendim.

- **Dëmet:** Dëmet janë kompensimi që i paguhet operatorëve ekonomik të dëmtuar nga një shkelje e rregullave të prokurimit publik. Procedura dhe vendi për paraqitjen e pretendimeve për dëmet varet nga legjislacioni vendas, i cili përcakton rregullat e paraqitjes së ankesave, afatet, kushtet e provës, si dhe shkallën e kompensimit (për shembull, kushtet në të cilat mund të mbulohen kostot e tenderimit). Ky mjet juridik ka për qëllim që të kompensojë operatorët ekonomik të dëmtuar.
- Masa që aplikohet, nëse një kërkesë për dëmet është e suksesshme, është kompensimi i të gjitha dëmeve të pësuar nga operatori ekonomik, kompensim i cili zakonisht përfshin kostot faktike të shkaktuara dhe, përjashtimisht, fitimet e humbura. Kompensimi duhet të jetë i plotë, megjithëse, shpesh është shumë e vështirë për të përcaktuar shkallën e dëmtimit të pësuar në një proces konkurrues. Ky mjet juridik nuk ndërhyr në procedurën e shpalljes së kontratës fituese dhe as në progresin apo përfundimin e saj.

### Çfarë është “periudha e ankesave”?

Autoritetet kontraktore duhet të presin për një numër të caktuar ditësh në periudhën ndërmjet vendimit për dhënien e kontratës dhe lidhjes së kontratës me ofertuesin e suksesshëm. Kjo "periudha e ankesave" u mundëson ofertuesve të refuzuar që të kundërshtojnë vendimin e autoritetit kontraktor për të mos u dhënë kontratën atyre, nëse ata mendojnë se një vendim i tillë ishte i paligjshëm, dhe, për këtë arsye, të parandalojnë lidhjen e kontratës në bazë të një vendimi të papërshtatshëm të shpalljes së kontratës fituese.

**Cilat janë kërkesat njoftimit për periudhën e ankesave?** Menjëherë pasi autoritetet kontraktore të kenë marrë një vendim për dhënien e kontratës, ato duhet të njoftojnë të gjithë ofertuesit ose kandidatët, duke përfshirë edhe ato të pasuksesshëm, për këtë vendim dhe pastaj të lejojë kalimin e një numri të caktuar ditësh para se të lidhin kontratën. Njoftimi duhet të përfshijë një përmbledhje

të arsyeve për këtë vendim, siç përcaktohet në Direktivat e mjeteve juridike, dhe, në veçanti, emrin e ofertuesit të suksesshëm dhe karakteristikat dhe përparësitë përkatëse të ofertës së zgjedhur; informacione të caktuara mund të mos jepen. Kohëzgjatja e saktë e periudhës së pritjes së ankesave duhet të përmendet gjithashtu edhe në njoftimin që ofertuesit/kandidatët e dinë se sa kohë ata kanë në dispozicion për të kundërshtuar vendimin e dhënies së kontratës, në qoftë se ata duan ta bëjnë këtë.

**Sa zgjat periudha ankesave?** Periudha e ankesave duhet të zgjasë të paktën 10 ditë, duke filluar nga dita pas datës në të cilën autoriteti kontraktor dërgon njoftimin e vendimit për dhënien e kontratës tek tenderuesit ose kandidatët, në qoftë se përdoret faksi ose mjetet elektronike. Periudha e ankesave mund të jetë më e gjatë nëse autoriteti kontraktor përdor mjete të tjera të komunikimit, të tilla si shërbimi postar për të dërguar njoftimin e vendimit për dhënien e kontratës. Këto periudha të prirjes së ankesave përbëjnë vetëm kërkesat minimale: e drejta vendore mund të parashikojë periudha më të gjata, por nuk mund të parashikojë periudha më të shkurtra.

Gjatë kësaj periudhe të pritjes së ankesave, ofertuesit e refuzuar mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit të dhënies së kontratës ose pranë autoritetit kontraktor duke përdorur procedurën e ankesave, dhe/ose direkt para organit shqyrtues, duke kërkuar vendosjen e masave të përkohshme ose vendosjen e masave pezulluese ndaj vendimit të dhënë për shpalljen e fituesit. Kjo zgjedhje varet nëse ankesat paraprake janë parashikuar sipas të drejtës vendor apo jo dhe nëse këto ankesa janë fakultative ose të detyrueshme para përdorimit të mjeteve të tjera juridike.

**A zbatohen kërkesat e njoftimit të për të gjitha vendimet e shpalljes së kontratave fituese?** Kërkesat për periudhën e ankesave zbatohen për shumicën e vendimeve të dhënies së kontratave. Direktivat e mjeteve juridike kanë parashikuar disa përjashtime si më poshtë vijon:

- Vendimi ka të bëjë me dhënien e kontratave të veçanta në bazë të një marrëveshjeje kuadër ose në bazë të një sistemi dinamik blerjeje.
- Nuk ka asnjë detyrim në bazë të Direktivës 2014/24/BE<sup>4</sup> për të publikuar Njoftimin e Kontratës.
- Në fazën e dhënies së procedurës ka mbetur vetëm një ofertues/kandidat; në këtë rast, nuk ka persona të tjerë të mbetur në procedurën e prokurimit që kanë një interes ose të drejtë për të kundërshtuar vendimin për dhënien e kontratës dhe për të përfituar nga periudha e pritjes së ankesave.

## **Pavlefshmëria e kontratave të lidhura**

Direktivat e mjeteve juridike kërkojnë që shtetet anëtare të sigurojnë që organet vendore të shqyrtimit të pezullojnë ose të shpallin të pavlefshme një kontratë të lidhur kur nuk janë përmbushur kushtet specifike, të tilla mospublikimi i njoftimit të kontratës dhe kryerja e procedurës së prokurimit, mos-përputhshmëria me rregullat e aplikimit për dhënien e kontratave në bazë të marrëveshjes kuadër, ose shkelja e kërkesave të pritjes së ankesave që dëmtojnë ofertuesit dhe i privojnë ata nga mundësia për të kërkuar masa të përkohshme ose masa pezulluese.

Sanksioni i pavlefshmërisë është miratuar për të parandaluar autoritetet kontraktore që ato të mos nxitojnë për të lidhur kontrata, edhe në shkelje të periudhave të pritjes së ankesave ose të pezullimit apo të rregullave bazë të prokurimit, duke supozuar se ato janë imune ndaj sanksioneve pas lidhjes së këtyre kontratave. Sanksioni kishte për qëllim të nxiste nëpunësit e prokurimit që ata të jenë shumë të kujdesshëm kur të zbatojnë rregullat e prokurimit. Rreziku i ndërprerjes së kontratave të lidhura në mënyrë të paligjshme është një rrezik serioz. Një tjetër rrezik serioz është se

---

<sup>4</sup>Direktiva 2014/24/BE për prokurimet publike dhe shfuqizimin e Direktivës 2004/18/KE, 26 shkurt 2014.

ofertuesi i suksesshëm, kontrata e të cilit është lidhur në këtë mënyrë, do të kërkojë dëmshpërblim sipas të drejtës vendore të kontratave.

Veprimi ligjor për të pezulluar një kontratë të nënshkruar ndërmerret nga tenderues që pretendon se ai do të dëmtohet. Direktiva u kërkon Shteteve Anëtare që të lejojnë periudhat kohore minimale dhe të përcaktuara për të bërë një kërkesë të tillë, por këto periudha janë vetëm kërkesa minimale, dhe për këtë arsye afatet dhe procedurat e hollësishme për ankesa të tilla rregullohen me të drejtën vendore.

Shtetet Anëtare kanë mundësinë që kontratat t'i shpallin të pavlefshme ose në mënyrë prapavepruese, ose në mënyrë jo prapavepruese. Pra, e drejta vendore do të përcaktojë nëse deklarata e vlefshmërisë është:

- Prapavepruese: kështu që të gjitha detyrimet kontraktuale, duke përfshirë edhe ato të kryera tashmë, duhet të anulohen, dhe ofertuesi dhe autoriteti kontraktor duhet të vendosin marrëdhëniet e tyre sipas rregullave vendore; ose
- Jo prapavepruese: kështu që vetëm detyrimet e ardhshme dhe të pakryera kontraktuale mund të anulohen. Ku Shteti Anëtar zgjedh anulimin jo prapaveprues, Direktiva kërkon që duhet të jenë të disponueshme edhe dënimet e tjera. Këto dënime shpesh janë (1) gjokat që vendosen nga autoriteti kontraktor, të cilat duhet të jenë mjaftueshmërisht të larta për të ndëshkuar paligjshmërinë; dhe (2) shkurtimin e kontratës.

Direktiva lejon që organeve të rishikimit t'i jepet diskrecion në qoftë se ato gjejnë se ka arsye thelbësore që lidhen me një interes të përgjithshëm për ruajtjen e kontratës. Ky diskrecion duhet të përdoret me kujdes, ashtu siç lejohet si një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm që kontratat e lidhura në mënyrë të paligjshme duhet të rrëzohen.

**Pavlefshmëria dhe Njoftimi Vullnetar ex ante i Transparencës (njoftimi NVET):** Kur autoriteti kontraktor vlerëson se ka të drejtë për të shpallë direkt fituese një kontratë pa shpalljen e njoftimit të kontratës, atëherë në bazë të nenit 2d (4) të Direktivës 89/665/KEE ai mund të botojë një njoftim NVET në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian*. Njoftimi NVET shpall qëllimin e autoritetit kontraktor për të dhënë kontratën. Kur autoriteti kontraktor boton njoftimin NVET dhe respekton periudhën e pritjes së ankesave prej të paktën 10 ditësh, duke filluar nga dita pas datës së publikimit të njoftimit para nënshkrimit të kontratës, atëherë kontrata mund të lidhet pa ndonjë rrezik pavlefshmërie, përveç rastit kur është bërë ankim ligjor gjatë periudhës së ankesave. Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian e konsideron korrekt përdorimin e njoftimit NVET në Çështjen *Fastweb C-19/13*.

#### **Shënim i praktikës së mirë**

Është e dobishme që të përfshihen në materialin e njoftimit të gjitha dokumentet mbështetëse të vendimit të dhënies së kontratës, të tilla si opinionet apo rekomandimet e komisionit të vlerësimit të ofertave. Kërkesat për zbulimin e dokumenteve mbështetëse, siç kërkohet nga e drejta vendore, mund të çojnë në një zgjatje të periudhës së pritjes së ankesave.

### **Parimet e përgjithshme që duhet të respektohen nga organet shqyrtuese dhe autoritetet kontraktore në lidhje me mjetet juridike**

Shtetet Anëtare, si dhe organet vendore të shqyrtimit dhe autoritetet kontraktore duhet të respektojnë gjatë procedurave të tyre të prokurimit parimet e përgjithshme që janë dhënë më poshtë në kuadër të zbatimit të Direktivave të mjeteve juridike:

- **Mosdiskriminimi:** aksesit në mjetet juridike duhet të jetë i hapur për të gjithë operatorët ekonomik pa diskriminim, veçanërisht mbi bazën e kombësisë. Mjetet juridike të zbatimit të rregullave të prokurimit publik të BE-së dhe kushtet e tyre (rregullat procedurale, siç janë

afatet kohore dhe kërkesat e dosjeve) duhet të jenë po aq të favorshme sa ato që janë në dispozicion për të zbatuar rregullat e brendshme të prokurimit.

- **Vlefshmëria:** Mjetet juridike duhet të kenë fuqi të mjaftueshme për të siguruar respektimin e rregullave të prokurimit publik të BE-së, ndërkohë që shqyrtimi duhet të jenë sa më i shpejtë që të jetë e mundur. Ky parim do të thotë që autoritetet kontraktore duhet të përpiqen për të lehtësuar zhvillimin e duhur të të gjitha procedurave ligjore dhe duhet që gjithmonë të veprojnë në përputhje me vendimet që lidhen me mjetet juridike. Procedurat ligjore dhe sjellja e organeve të shqyrtimit duhet të sigurojnë shqyrtim dhe zgjidhje të shpejtë.
- **Transparenca:** Autoritetet kontraktore duhet të sigurojnë që operatorëve ekonomik t'u jepet , me anë të vetë dokumenteve të tenderit si dhe me anë të njoftimeve të vendimeve të kontraktimit, informacioni maksimal si më poshtë vijon:
  - Të drejtat ndaj mjeteve juridike sipas ligjit, në mënyrë të veçantë ndaj mjeteve që kanë të bëjnë me kryerjen e procedurës së prokurimit, d.m.th., masat e përkohshme dhe masat pezulluese;
  - Rregullat përkatëse procedurale, në mënyrë të veçantë afatet e caktuara dhe emrat e personave/komisioneve që marrin ankesat e para-gjyqimit brenda autoritetit kontraktor;
  - Si janë marrë vendimet kontraktore, në masën që ky informacion është i rëndësishëm për operatorët ekonomikë.

Organet e shqyrtimit duhet të veprojnë në përputhje me kërkesat e Direktivave të mjeteve juridike dhe legjislacionit vendas, dhe sjellja dhe vendimmarrja e tyre duhet të jetë e hapur dhe transparente.

Për informacion të mëtejshëm shih Udhëzimin nr. 25 të SIGMA-s për Prokurimin publik, *Krijimi i organeve të shqyrtimit të prokurimit*.

## Shërbimet

Edhe Direktiva 92/13/KEE (e ndryshuar nga Direktiva 2007/66/KE) parashikon tre mjetet juridike të masave të përkohshme, të masave pezulluese dhe të dëmeve.

Direktiva 92/13/KEE i jep Shteteve Anëtare mundësi që në vend të masave të përkohshme dhe pezulluese për vendimet e paligjshme ato të parashikojnë pagesën e një shume (të tillë si një gjobë), kur ndodh një shkelje e rregullave të prokurimit. Kjo shumë duhet të jetë mjaft e lartë për t'i dekurajuar subjektet kontraktore që ato të kryejnë (ose të ndihmojnë) një shkelje.

Periodha e ankesave, detyrimi për të njoftuar lidhur me dhëniet e drejtpërdrejta të kontratave, dhe sanksioni i pavlefshmërisë e kontratave, të cilat vlejnë për autoritetet kontraktore, zbatohen edhe për subjektet kontraktore.



## Informacion i mëtejshëm

### Botimet e SIGMA-s

*Manuali i Trajnimit për Prokurimin Publik – Moduli F1*

<http://www.sigmaweb.org/publications/public-procurement-training-manual.htm>

SIGMA (2007), *Sistemet e shqyrtimit të prokurimit publik dhe të mjeteve juridike në Bashkimin Evropian, Dokumenti i SIGMA-s No. 41, Botimet e OECD-së, Paris.*

[http://www.sigmaweb.org/publications/Alb\\_SP41\\_07.pdf](http://www.sigmaweb.org/publications/Alb_SP41_07.pdf)

SIGMA (2014), *Aktgjykime të zgjedhura të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian mbi Prokurimin Publik (2006-2014), Botimet e OECD-së, Paris*

<http://www.sigmaweb.org/publications/Judgements-CourtJustice-31July2014-Alb.pdf>

Udhëzimet e Prokurimit Publik

<http://www.sigmaweb.org/publications/key-public-procurement-publications.htm>

Udhëzimi i Prokurimit Publik 1, *Prokurimi Publik në BE: Kuadri legjislativ, parimet themelore dhe institucionet*

Udhëzimi i Prokurimit Publik 25, *Ngritja e organeve të shqyrtimit të prokurimit*